




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/01

Datë: 13.03.2020

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, nenit 43 të Statusit të Komunës së Junikut, neni 44 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës së Junikut me datë: 13.03.2020, lëshon këtë:

URDHERESË

- I. OBLIGOHEN- Të gjithat Subjektet Afariste dhe ambientet publike të cilat veprojnë në territorin e Komunës së Junikut, që të bëjnë dezinfektimin e hapësirave brenda objekteve dhe hapësirave para dhe përreth objekteve për çdo ditë, me qëllim të mirëmbajtjes së ambientit në të cilin ne po jetojmë dhe po verojmë.
- II. Mosrespektimi i kësaj urdhërese administrative do të konsiderohet si shkelje e dispozitave ligjore dhe nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe do të merren masa ndëshkuese nga organi kompetent.
- III. Për zbatimin e kësaj urdhërese do të kujdeset Drejtoria për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Junikut dhe Policia e Kosovës – Stacioni Policor në Junik.
- IV. Kjo Urdhëresë hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me këtë të njoftohet:

1. Drejtoria për Shërbime Publike, I.M.Sh,
2. Stacioni Policor në Junik,
3. Subjektet Afariste,
4. Arkivi komunal.

Kryetari:
Agron K...

